

ALGERT KALICA

EMRAT E LËNDËS NË STUDIME

0. Hyrje

Librat e gramatikës nuk i trajtojnë sa duhet emrat e lëndës. Këta, gjithnjë e më shumë po bëhen objekt studimi i shumë fushave të gjuhësisë, si sintaksa, semantika, por edhe shkencave të tjera si filozofia, psikologjia dhe neurologjia. Megjithatë, me sa dimë, nuk ka një punim që të paraqesë gjendjen e deritanshme të këtyre studimeve. Ndaj, nga njëra anë, u pa e nevojshme të mbushet boshllëku që lënë librat e gramatikës, nga ana tjetër, të paraqitet gjendja e deritanishme e studimeve gjuhësore e ndërgjuhësore si dhe të shihet, sa të jetë e mundur, se cilat përgjithësime rreth kësaj klase leksikore i shkojnë për shtat edhe shqipes. Për këtë qëllim, si metodë analize, kemi përdorur sintezën e studimeve me objekt emrat e lëndës brenda një gjuhe por edhe në planin ndërgjuhësor. Gjithashtu, kemi parë nëse këto përgjithësime dhe rezultate analizash mund t'i vishen shqipes. Prandaj, aty këtu, kemi sjellë shembuj nga shqipja, për të nxjerrë në pah, në planin ndërgjuhësor të përbashkëtat e dallimet, por edhe për të njohur më mirë këtë klasë leksikore brenda shqipes.

Struktura e këtij punimi ndjek kriterin nga e thjeshta tek e ndërlikuara duke lënë në fund përjashtimet. Pas hyrjes, sqarohet dallimi jashtëgjuhësor send – substancë dhe analogu i tij brendagjuhësor emër lënde – emër i numërueshëm. Më pas ndalemi tek vetitë morfologjike e sintaksore të emrave të numërueshëm dhe të lëndës. Pastaj hedhim një vështrim mbi tri grupet e gjuhëve sipas mënyrës sesi kodohet dallimi emër lënde – emër i numërueshëm siç i kanë nxjerrë analizat ndërgjuhësore. Më tutje, merremi me dy format e kalimit nga lënde në të numërueshëm dhe një formë të kalimit të ndërsjellë, pra nga të numërueshëm në lënde. Deri këtu, temat ndjekin planin nga e thjeshta tek e ndërlikuara. Paskëtaj, vijnë dy temat që u përkasin përjashtimeve. Shkurtimisht shohim edhe ndarjen që u kryen gjuhësia angleze emrave abstraktë në lënde dhe të numërueshëm. Pastaj shohim një dukuri sidomos të anglishtes: atë të emrave të rremë të lëndës. Së fundi nxjerrim disa përfundime nga kjo sintezë studimesh.

Siç thamë, materiali përbëhet nga artikuj shkencorë, rezultate studimesh, disertacione e tema doktoratash. Tërë referencat janë botime të dala nga shtypi, me përjashtim të një libri elektronik të universitetit të

Pensilvanisë (SHBA) me autorë Beatrice Santorini dhe Anthony Kroch. Fillimisht u kryen kërkime elektronike me fjalë kyçe në katalogët e bibliotekave në linjë si *Bibliothèque Nationale de France*, etj. dhe në katalogët e bibliotekave të universiteteve si ajo e Harvardit, Oxfordit, etj. (shih bibliografinë) dhe motore kërkimi artikujsh shkencorë e studimesh si *jstor.org*, *persee.fr*, *academia.edu*, *researchgate.net*, *cairn.info* e shumë të tjerë. Vetëm artikujt me referenca të sakta të kopjes së shtypur u morën në konsideratë. Ndonjëherë, kur artikulli ishte i rëndësishëm por kishte referenca të paplota, na u desh të komunikonim me faqen elektronike nga e kishim shkarkuar për t'i marrë ato. Ndonjëherë, kemi komunikuar me autorin me postë elektronike, siç është rasti i studiueses Eliana Colunga e cila na nisi me postë elektronike të skanuar tërë librin e punimeve të konferencës, ku ne mund të gjenim saktësisht faqen, botuesin, vitin, ISBN-në etj. Ndonjëherë, pasi e kishim shkarkuar në burimet e sipërpërmendura e kërkim artikullin në *google books*, ku shfaqeshin referencat e sakta të kopjes së dalë nga shtypi. Ndonjëherë e blemë tërë revistën me artikuj shkencorë, kur, tek përmbajtja shihnim se, përveç artikullit që kishim shkarkuar, ndodheshin edhe artikuj të tjerë të rëndësishëm.

1. Dallimi ontologjik send – substancë dhe dallimi gjuhësor i numërueshëm – lëndë

Një dallim themelor, i mësuar që në vegjëli, është ai midis sendeve më vete dhe materialit nga i cili përbëhen. Të parat numërohen, ndërsa i dyti matet. Filozofët Francis Pelletier¹ dhe Tyler Burge² e kanë trajtuar këtë dallim me kategori si formë dhe lëndë, substrakt dhe substancë, mënyrë dhe zgjerim, jo përfshirës dhe përfshirës. Sipas konceptimit, sendet janë njësi të plota të kufizuara dhe më vete. Prandaj, filxhani është send dhe filxhani është tërë gjëja bashkë me formën e tij të veçantë. Një filxhan i thyer nuk është filxhan. Po ashtu sendet ose individët³ (*dritare, çekan, karrige, thikë, qen*) janë realie të përkapshme që, po të bashkohen me njëri – tjetrin, nuk formojnë një referent tjetër të të njëjtit lloj⁴. Kështu, bashkimi

¹ F. J. Pelletier, *Mass Terms: Some Philosophical Problems*. Reidel, Dordrecht, 1979.

² T. Burge, "Mass terms, count nouns and change", në "Synthese" 31, f. 459 - 468, 1975.

³ Në studime parapëlqehet termi *individ* për të përfshirë frymorët dhe referentë që emri *send* nuk mund t'i emërtojë, si *vrinë*. Prandaj ne do ta përdorim shpesh emrin *individ*.

⁴ J. Macnamara, G. E. Reyes, *The Logical Foundation of Cognition*. Oxford University Press, Oxford, 1994.

i dy qenve nuk formon një qen të vetëm. Nga ana tjetër, substancat ose materialet janë lëndë të vazhdueshme pa caqe, pasi janë ekzistenca të njënjëshme caqet e të cilave nuk rroken nga pikëpamja përkapëse (perceptuese)⁵. Ato mund të bashkohen ose ndahen pa e ndryshuar natyrën e tyre. Kështu substancat ose materialet (*uji, sheqeri, vera*) po të bashkohen me realie të të njëjtit lloj formojnë një realie më të madhe; po të ndahen, formojnë realie më të vogla. Më konkretisht, dy a më shumë trupa uji mund të bashkohen e të formojnë një trup të vetëm uji, duke i zhdukur kufijtë fillestarë të të dy trupave⁶. Gjithashtu, çdo pjesë uji, qoftë në pika qoftë në pellgje, është ujë.

Analogu gjuhësor i dallimit midis sendit dhe substancës është dallimi midis emrave të numërueshëm dhe emrave të lëndës, sepse dallimet ontologjike pasqyrohen nga vetitë gramatikore dhe kuptimi leksikor i të dyja klasave leksikore⁷. Pra, ka një marrëdhënie midis dallimit send-substancë nga njëra anë dhe sintaksës, kuptimit leksikor të emrave numërueshëm dhe emrave të lëndës nga ana tjetër. Kështu, emrat e lëndës u referohen referentëve të konceptuar si substanca pa caqe, ndërsa emrat e numërueshëm u referohen referentëve të konceptuar si sende më vete (individë) e të numërueshme. Lidhja e emrave të lëndës dhe e emrave të numërueshëm me kontrastin e tyre konceptor jashtëgjuhësor substancë – send është një gjithësor (universal) që studiuesit e quajnë *vetia e lidhjes dydrejtimëshe (mapping property)*⁸. Kjo lidhje mund të karakterizohet siç vijon: “Në çdo gjuhë L, substancat kodohen si lëndë nga testet që mbizotërojnë në L”⁹. Nga këto teste, p.sh., emrat gjak ose ajër në asnjë gjuhë nuk dalin si të numërueshëm. Ky është një gjithësor (universal) tejet i fortë dhe i qëndrueshëm. Edhe e kundërta është e vërtetë: “Në çdo gjuhë

⁵ C. Semenza, S. Mondini, M. Cappelletti, “*The grammatical properties of mass nouns: An aphasia case study*”, në “*Neuropsychologia*”, Vol 35, No 5, © 1997 Elsevier Science Ltd, Printed in Great Britain, f. 669 – 675, 1997.

⁶ J. Macnamara, G. E. Reyes, *The Logical Foundation of Cognition*. Oxford University Press, Oxford, 1994.

⁷ W. J. M. Levelt, *Speaking: From Intention to Articulation*. MIT Press, Cambridge, MA, 1989.

⁸ G. Chierchia, *Mass nouns, vagueness and semantic variation*, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

⁹ G. Chierchia, “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

L, sendet (individët) kodohen si të numërueshëm”^{10 11}. Këtu është e udhës të japim edhe një përkufizim të secilës klasë leksikore: “Një fjalë bën pjesë në kategorinë sintaksore të emrave të lëndës (si *ujë*, *calcium*, *bollgur tërshëre*), nëse emërton substanca [a materiale...]. Emrat e numërueshëm janë fjalë (si *qen*, *dritare*, *çekan*) të cilat u vishen individëve (sendeve)”¹².

2. Vetitë gramatikore të emrave të numërueshëm dhe të lëndës

Në gjuhë si anglishtja, frëngjishtja dhe italishtja, janë vetitë sintaksore që ndajnë të dyja klasat leksikore: emrat e lëndës nga emrat e numërueshëm¹³. Në anglishte, shënimi i numrit ka efekt dallgë, pasi emrit i cakton statusin: i numërueshëm ose lëndë. Emrat e numërueshëm si *cat* (*mace*), *cup* (*filxhan*) kanë shumës. Përveç shumësit, kanë edhe një sërë vetish morfosintaksore që dëshmojnë sesa i ndjeshëm është sistemi përcaktor ndaj dallimit lëndë – i numërueshëm:

Kanë nyje shquese dhe joshquese, dhe kjo e fundit shkon vetëm me emrat e numërueshëm (*a boy*). Mund të ndjekin numërorë themelorë dhe nuk marrin përcaktorë sasiore që tregojnë masë substance, si *much* dhe *little*, por marrin disa përcaktorë që nënkuptojnë numër sendesh më vite (individësh), si *these* (*këta*), *those* (*ata*), *few* (*ca*), *several* (*disa*), *many* (*shumë*), p.sh., *many cats* (*shumë mace*)¹⁴. Ka përcaktorë sasiore të tjerë si *each* (*secili*), *every* (*çdo*) që shkojnë vetëm me njëjësën e emrave të numërueshëm *every boy* (*çdo djalë*)¹⁵. Po ashtu, një pjesë e mirë e

¹⁰ Sidoqoftë, siç do ta shohim më poshtë, anglishtja njeh një përjashtim me emrat e rremë të lëndës si *furniture* (*mobilim*), *footwear* (*këpucë, etj.*), *jewellery* (*stoli*), etj. që gramatikisht janë lëndë, por u vishen referentëve që fëmija paragjuhësor do të klasifikonte si sende.

¹¹ G. Chierchia, “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

¹² J. Macnamara, G. E. Reyes, *The Logical Foundation of Cognition*. Oxford University Press, Oxford, 1994.

¹³ B. S. Gillon, “*Towards a common semantics for English count and mass nouns*”, në *Linguistic and Philosophy* 15, f. 597 – 639, 1992.

¹⁴ D. Barner, J. Snedeker, “*Mapping individuation to mass-count syntax in language acquisition*”, Punim i paraqitur në *26th Annual Meeting of the Cognitive Science Society*, Zhvilluar 4-7 gusht, 2004, në Chicago, Illinois USA, Kenneth Forbus, Dedre Gentner and Terry Regier Editors, Copyright © 2005 by the Cognitive Science Society, f. 79 – 84. (ISBN 0-8058-5464-9; ISSN 1047-1316)

¹⁵ G. Chierchia, “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

përemrave të pacaktuar rimarrin vetëm emra të numërueshëm ose u referohen vetëm individëve (sendeve): *another, anybody, anyone, anything, each, either, everybody, everyone, everything, neither, nobody, noone, nothing, one, other, somebody, someone...*

Këto që thamë për anglishten, vlejnë edhe për shqipen. Edhe në shqipe, emrat e numërueshëm kanë edhe shumës, përcaktohen nga numërorë themelorë, marrin përcaktorë që nënkuptojnë numër sendesh më vete si përemra të pacaktuar *disa* etj, përemra dëftorë në shumës si *këta*, përcaktohen nga numërorë themelorë, p.sh. *një mollë, dy çanta*. Nyja joshqese *një* paraprin vetëm emra të numërueshëm: *erdhi një shok*.

Nga ana tjetër, emrat e lëndës si *water (ujë)*, nuk kanë dallimin morfologjik njëjës – shumës (por shih greqishten) dhe janë thuajse gjithnjë në njëjës. Për ta thënë me fjalët e Gennaro Chierchia-s, “emrat e lëndës prototip (konkretë) nuk kanë shumës të natyrshëm¹⁶”:

- 1 a. *That blood is RH Positive.* b. **Those bloods are RH Positive*
(Ai gjak është RH pozitiv). (*Ato gjaqe janë RH pozitive).

Sidoqoftë ka dhe përjashtime: *remains (mbeturina)* dhe *leftovers (ushqime të mbetura pas vaktit)* në anglishte, të lashtat në shqipe janë emra lënde në shumës.

Cilësitë e emrave të lëndës që vijojnë dëshmojnë se sistemi përcaktor është i ndjeshëm ndaj dallimit lënde - i numërueshëm. Nuk mund të marrin nyje joshqese: **a water*. Nuk mund të marrin numërorë themelorë¹⁷ e të tjerë përcaktorë sasiore që nënkuptojnë numër sendesh më vete (individësh), si *another (tjetër), many (shumë), each (secili), several (disa), every (çdo)* (**every water (*të gjithë ujë)*)¹⁸. Sidoqoftë, mund të marrin përcaktorë sasiore që tregojnë masë substance, si *some (ca), little (pak)* dhe *much (shumë)*: “*I don’t eat much porridge*” (“*Nuk ha shumë supë*”)¹⁹. Ka

¹⁶ G. Chierchia, “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

¹⁷ Ky, siç do ta shohim më poshtë, është një gjithësor që quhet vetia e firmës.

¹⁸ Shih: C. Semenza, S. Mondini, M. Cappelletti, “*The grammatical properties of mass nouns: An aphasia case study*”, në *Neuropsychologia*, Vol 35, No 5, © 1997 Elsevier Science Ltd, Printed in Great Britain, f. 669 – 675.

¹⁹ Shembull i marrë nga: E. Colunga, M. Gasser, “*Attention to Different Cues in Noun Learning: The Effect of English vs. Spanish Mass / Count Syntax*”, në

një klasë përcaktorësh sasiore, si *most*, *all*, që shkojnë edhe me shumësin e emrave të numërueshëm *most / all boys* (*shumica e djemve / të gjithë djemtë*) edhe me emrat e lëndës *most / all water* (*shumica e ujit / të gjithë ujin*), por përjashtojnë njëjësën e emrave të numërueshëm: **most / all boy* (**shumica / të gjithë djalë*)²⁰. Pa u zgjatur në hollësi, të gjitha këto që thamë për anglishten vlejnë edhe për shqipen, dhe, siç do ta shohim më poshtë, vlejnë edhe për të gjitha gjuhët me shumës të shënuar.

E përmendëm më lart se emrat e lëndës nuk mund të përcaktohen nga numërorë themelorë. Ky është një gjithësor (universal) që studiuesit e quajnë *vetia e firmës* (*signature property*)²¹. “Vetia gramatikore më fort e lidhur me emrat e lëndës është statusi i shënuar i tyre për të mos u kombinuar drejtpërdrejt me një numëror themelor”²². Pavarësisht nga rendi i fjalëve, përbërësit [NumP Num NMASS] ([SNum Num SLënde])²³ ose nuk janë aspak gramatikore ose ndihen sikur kanë nevojë të reinterpretohen si *tipe të prejardhura* pra për ndërrim të klasës leksikore nga lënde në të numërueshëm; për këtë do të flasim ca më tutje, tek *vetia e lakueshmërisë* (*elasticitetit*).

- 2 a. *Thirty three tables/stars/pieces of that pizza.* [NumP Num * *Thirty three* [NumP
b. *bloods/waters.*

Proceedings of the 26th annual Boston University Conference on Language Development, B. Skarabela, S. Fish and A. H.-J. Do Editons, Cascadilla Press, Somerville, MA. f. 107-117, 2002.

²⁰ Shih: G. Chierchia, “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

²¹ M. L. P. Reyes, J. Macnamara, G. E. Reyes, H. Zolfaghari, “*Count nouns, mass nouns and their transformations: a unified category-theoretic semantics*”, në *Language, Logic and Concepts: Essays in Honour of John Macnamara*. R. Jackendoff, P. Bloom and K. Wynn, eds., MIT Press, Cambridge, MA, f. 427–452, 1999.

²² G. Chierchia, “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

²³ Ku Num=Numeral (*number expression*) (Numëror (*shprehje numërore*)), NumP = Numeral Phrase (SNum=Sintagëm numërore). Një sintagëm numërore (Numeral Phrase) është diçka si *three apples* (*tri mollë*). Quhen sintagma mase (*Measure Phrase*) shprehjet si *three pounds of apple* (*tri livra mollë*). Së fundi, shënim numri nënkupton kontrastet njëjës / shumës.

<i>N</i> COUNT].	<i>Num</i> <i>N</i> MASS]
(<i>Tridhjetë e tre tavolina / yje /</i>	(<i>Tridhjetë e tre gjaqe /</i>
<i>copë të asaj pice. [S</i> Num <i>Num</i>	<i>ujëra. [S</i> Num <i>Num</i>
<i>S</i> NUMËRUESHËM])	<i>S</i> LËNDE]) ²⁴

Ky përgjithësim është i pavarur nga fakti se gjuhët me kombinime numëror – emër si anglishtja, kërkojnë shënim me shumës të emrit (për numërorë të ndryshëm nga *një*). Pamundësia e kombinimit të një emri lënde me një numëror ka të bëjë edhe me strukturat kryefjalë – kallëzues emëror, ku shënimi me numër nuk ndërhyt:

- | | | | |
|---|--|---|--|
| 3 | a. <i>Those boys are at least thirty</i> [PredP <i>N</i> PMASS
Pred Num]
<i>Ata djem janë së paku tridhjetë</i> [Fjali
kallëzuesore/ SE
LËNDE FOLJE(jam)
Numëror] | b. <i>*That gold is at least thirty</i>
<i>*Ai ar është të paktën tridhjetë.</i> | c. <i>That gold is at least thirty pounds.</i>
<i>Ai ar është të paktën tridhjetë livra</i> ²⁵ . |
|---|--|---|--|

Për më tepër, ka gjuhë si finlandishtja, tek të cilat ndonëse numërorët përbërës të sintagmave emërore kërkojnë që emri të përshtatet në njëjës, prapëseprapë kombinimi i një numërori me një emër lënde është devijues dhe / ose shkakton ndërrim të klasës leksikore nga lënde në të numërueshëm²⁶:

- | | | |
|---|--|--|
| 4 | a. <i>Yhdeksän omen-a</i>
<i>Nine-nom apple-part-</i> | b. <i>Yhdeksän vesi-a</i>
<i>Nine-nom water-part-SG</i> |
|---|--|--|

²⁴ Shembuj marrë nga: M. L. P. Reyes, J. Macnamara, G. E. Reyes, H. Zolfaghari, "Count nouns, mass nouns and their transformations: a unified category-theoretic semantics", në *Language, Logic and Concepts: Essays in Honour of John Macnamara*. R. Jackendoff, P. Bloom and K. Wynn, eds., MIT Press, Cambridge, MA, f. 427–452, 1999.

²⁵ Shembuj marrë nga: G. Chierchia, "Mass nouns, vagueness and semantic variation", në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

²⁶ D. Nelson, I. Toivonen, "Counting and the grammar: case and numerals in Inari Sami", në Nelson, D. Manninen, S. eds. *Generative Approaches to Finnic and Saami Linguistics*, CSLI Publishers, f. 313–334, 2003.

<i>SG</i>	<i>Nëntë-emërore</i>	<i>ujë-rasë</i>
<i>Nëntë-emërore</i>	<i>mollë-</i>	<i>përpjesore-njëjës</i>
<i>rasë përpjesore-njëjës</i>		

Përgjithësisht, për të kombinuar siç duhet një SLËNDE na duhet të ndërkallim një sintagmë mase, si *livër*, *litër* etj., si tek 5a apo një sintagmë sasiore, p.sh. emra enësh si *filxhan*, *lugë* etj., si tek 5b.

- 5 a. *tri livra sheqer (three pounds of sugar)*
b. *tri filxhanë sheqer (three cups of sugar)*

Pamundësia (në kuptimin e mësipërm) për të kombinuar drejtpërdrejt një numëror me një emër lënde duhet të jetë gjithësor (universal). Për shembull në gjuhën mandarine 6a është e gabuar, por 6b është e saktë²⁷. Po kështu edhe në gjuhën *dëne sylene*, 6c është e gabuar, por 6d është e saktë²⁸.

- 6 a. **san rou (*tre mish)* c. **solaghe bër (*pesë mish)*
b. *san bang rou (tri livra mish)* d. *solaghe nedadhi bër (pesë livër mish)*

3. Klasifikimi i gjuhëve sipas kodimit lënde / i numërueshëm

Sipas mënyrave sesi kodohet dallimi emër lënde / emër i numërueshëm, gjuhët klasifikohen në sasiore (klasifikuese), me numër asnjanes dhe me shumës të shënuar²⁹.

3.1. Gjuhët sasiore (klasifikuese)

Në gjuhë si kinezishtja mandarine asnjë emër nuk mund të kombinohet drejtpërdrejt me numërorë themelorë. Nevojitet gjithnjë një fjalë sasiore,

²⁷ Shih: Ting-Chi Wei, "Nominal predicates in mandarin chinese", në *Taiwan Journal of Linguistics*, Vol. 5.2, f. 85 – 130, 2007.

²⁸ A. Wilhelm, "Bare Nouns in Dëne Sylene", në *Natural Language Semantics*, 16, f. 39-68, 2008.

²⁹ Shih: Marie La Palme Reyes, J. Macnamara, G. E. Reyes, H. Zolfaghari, "Count nouns, mass nouns and their transformations: a unified category-theoretic semantics", në *Language, Logic and Concepts: Essays in Honour of John Macnamara*. R. Jackendoff, P. Bloom and K. Wynn, eds., MIT Press, Cambridge, MA, f. 427–452, 1999.

pra një fjalë që tregon diçka si masë, një enë, apo fjalë me bazë forme që shprehin diçka si ‘njësi’. Ja dy shembuj marrë nga Lisa Cheng³⁰:

- | | |
|--|---|
| 7 a. <i>san *(ge) nanhai</i>
<i>three CL (classifier like) boy</i>
<i>‘three boys’</i>
<i>tre FK (fjalë sasiore) djalë</i>
<i>‘tre djem’</i> | b. <i>yi *(ben) shu</i>
<i>one CL (classifier like)</i>
<i>book ‘one book’</i>
<i>një FK (fjalë sasiore)</i>
<i>libër ‘një libër’</i> |
|--|---|

Gjuhë si këto shpesh quhen *gjuhë sasiore (klasifikuese)*, meqë përdorin përcaktorët sasiore për të shënuar sasi. *Gjuhët sasiore* nuk e kanë me detyrim shënimin e numrit tek emrat, madje në të vërtetë vihet në diskutim nëse dëshmohet dallimi njëjës – shumës. Në gjuhën mandarine, gjejmë forma si *burra* që, kur kombinohen me emra, tregojnë *grumbull* dhe lidhen me idenë e shumës. Yen-Hui Audrey Li³¹ pretendon se *burra* është një morfemë e vërtetë shumësi. Sidoqoftë, sintaksa dhe semantika e kësaj fjalëforme duket shumë ndryshe nga ajo e morfemave që shënojnë numrin. P.sh. kufizohet tek njerëzit, mund të shfaqet edhe në emra të përveçëm, ka vetëm një interpretim të përcaktuar, etj. Për një alternativë të analizës së studiuesit Yen-Hui Audrey Li, shih Takeo Kurafuji³². Megjithatë mund të mbrohet kjo që në gjuhë të tilla çdo emër ka një makro-sintaksë që ngjan me atë të emrave të lëndës në anglishte, duhet pasur parasysh se dallimi lënde – i numërueshëm gjallon edhe në gramatikën e tyre. Veçanërisht, *sasioret (klasifikuesit)* me bazë forme si *pan (enë)* ose ata të papërcaktuar si *ge* ose nuk kombinohen me emra lënde prototip ose të detyrojnë t’i interpretosh si të numërueshëm, siç do të shohim më tutje, tek shembulli 21c. Kësi sasiorësh ‘të numërueshëm’ kanë edhe një përndarje sintaksore që ndryshon në shumë dimensionë nga përndarja e sasiorëve që nuk kufizohen tek emrat e numërueshëm. P.sh., futja e pjesëzës *de*, që në vija të përgjithshme tregon modifikim, është e mundur pas sasiorësh që shkojnë

³⁰ L. L. Cheng, R. Sybesma, “Yi-wang Tang, yi-ge Tang: Classifiers and Massifiers”, në *Tsing Hua Journal of Chinese Studies*, XXVIII(3), f. 385-412, 1998.

³¹ Yen-Hui Audrey LI, “Plurality in a Classifier Language”, në *Journal of East Asian Language*, Vol. 8, f. 75-99, 1999.

³² T. Kurafuji, “Plural Morphemes, Definiteness and the Notion of Semantic Parameter”, në *Language and Linguistics*, n. 5.1, f. 211-242, 2004. (ISBN: 2004-0-005-001-000077-1).

me emra lënde, por jo pas sasioresh që shkojnë me emra të numërueshëm, siç tregojnë këta shembuj marrë nga Lisa Cheng dhe Rint Sybesma³³:

- | | |
|--|---|
| 8 a. * <i>san ben de shu</i>
tre FK (fjalë sasiore) –
de libër
three CL (classifier
like) -de book | b. <i>san bang de shu</i>
tre livër –de libër ‘tre livra libra’
ose ‘tre livra libër’
three pound-de book ‘three pounds
of books’ or ‘three pound book’ |
|--|---|

Pra, mënyra sesi dallimi lënde – i numërueshëm kodohet në gramatikën e gjuhëve si kinezishtja është me anë të sintaksës dhe semantikës së sasioreve (klasifikuesve).

3.2. Gjuhë me numër asnjës

Ka një tip tjetër të larmishëm gjuhësh – si gjuhët austroneziane studiuar nga Maria Polinsky³⁴, si tonganishtja, ose gjuha *dëne sɯline* – që nuk ka as shënim të detyruar numri as sisteme me sasiore të detyrueshëm. Sipas kësaj veçorie, këto gjuhë quhen *gjuhë me numër asnjës emri*. Gjuha *dëne sɯline* përshkruhet qartë si e tillë nga Andrea Wilhelm-i³⁵. Le të rishikojmë shpejt këtë model sipas tij. Fjalitë e mëposhtme tregojnë se forma bazë ka edhe njëjës in edhe shumës in:

- | | |
|---|--|
| 9 a. <i>tth'ay thiltɕi</i>
dish perf-1SG-make SG O | <i>sɿ</i>
assert ‘I made one dish’ (‘Bëra një enë’) |
| b. <i>tth'ay perf</i>
dish <i>ghigha</i>
perf-1SG-make PL O | <i>sɿ</i>
assert ‘I made several dishes’
(‘Bëra disa enë’) |

Për më tepër, shqyrtimi i sintaksës i përbërësve numëror emër [NumN] shfaq menjëherë se gjuhës *dëne sɯline* i mungojnë sasioret e detyrueshëm.

- 10 a. *sɔlaghe dzol* b. *sɔlaghe k'asba* c. **sɔlaghe bër*

³³ Shih: L. L. Cheng, R. Sybesma, “Yi-wang Tang, yi-ge Tang: Classifiers and Massifiers”, në *Tsing Hua Journal of Chinese Studies*, XXVIII(3), f. 385-412, 1998.

³⁴ M. Polinsky, E. Potsdam, *Austronesian syntax*, Bill Palmer (ed.) Oceania. Berlin: Mouton.

³⁵ A. Wilhelm, “Bare Nouns in Dëne Sɯline”, në *Natural Language Semantics*, 16, f. 39-68, 2008.

<i>five ball</i>	<i>five chicken</i>	<i>five meat</i>
<i>pesë top</i>	<i>pesë pulë</i>	<i>pesë mish</i>

Në të njëjtën kohë, siç tregohet më lart tek (6c) dhe këtu, (10c), numërorët nuk mund të kombinohen me emrat e lëndës. Prandaj, dallimi lënde – i numërueshëm në gjuhë të këtij lloji, mesa duket shfaqet në sintaksën e numërorëve. Duke pranuar se sasioret e detyrueshëm dhe morfologjia e numrit janë dy elemente të ndryshme të sistemit të përshtatjes së emrit, gjuhë si *dëne syline* nuk shfaqin shenja të qarta të një sistemi të këtij lloji.

3.3. Gjuhë me shumës të shënuar

Këtë etiketë marrin gjuhët që kanë tipare të theksuara numri të cilat detyrimisht shfaqen tek emra dhe mund të shfaqen në të tjerë përbërës të sintagmës emërore. Gjuhët indoevropiane (përfshirë shqipen), ugrofine, etj., janë gjuhë të këtij tipi. Dallimi lënde – i numërueshëm në gjuhë me shumës të shënuar kryesisht përqendrohet në përndarjen e morfologjisë njëjës – shumës. Këto veçori i kemi parë në krye të këtij studimi. Këtu është e udhës të ndalemi tek ndryshimet brenda këtij grupi gjuhësh. Ndonëse kjo është një karakteristikë pak a shumë e fortë, propëseprapë dëshmohet edhe ndryshimi. Sipas, gjuhëtarit George Tsoulas³⁶, greqishtja e re lejon lehtësisht shumësin e emrave të lëndës:

- 11 *Epesan nera sto kefali mu.*
(*Më ranë ujëra mbi kokë*).

Në studimin e Tsoulas-it³⁷, shënimi i shumësit të emrave të lëndës duket se funksionon në mënyrë të ngjashme me një përcaktor sasiore, si *a lot of (shumë)*, që i jep kuptimin se sasia e ujit që ‘bie në kokën time’ është e madhe³⁸. Saktësisht i njëjti model mesa duket qëndron në shumë gjuhë të

³⁶ G. Tsoulas, “Plurality of Mass Nouns and the Grammar of Number”, punim i paraqitur në 29th Glow Meeting, Barcelona, 2006.

³⁷ G. Tsoulas, “Plurality of Mass Nouns and the Grammar of Number”, punim i paraqitur në 29th Glow Meeting, Barcelona, 2006.

³⁸ G. Chierchia, *Plurality of Mass Nouns and the Notion of ‘Semantic Parameter’*, në S. Rothstein (ed.) *Events and Grammar*, Kluwer, Dordrecht, 1998.
G. Chierchia, “Reference to Kinds across Languages”, në *Natural Language Semantics*, 6: 339-405, 1998.

Amerikës së Veriut. P.sh., Mathieu³⁹ argumenton se *ojibwe*, një gjuhë algonkuine ka njëfarë dallimi lënde – i numërueshëm por lejon shumësin e emrave të lëndës me të njëjtin interpretim si në greqishte. Gillon⁴⁰, ka të njëjtin pretendim për gjuhën *innu-aimuine*, dialekt i Kresë (Cree) Lindore.

Ka edhe të tjera ndryshime në kontrastin lënde – i numërueshëm tek gjuhët me numër të shënuar. Vetitë morfosintaksore dhe semantike mund të ndryshojnë nga gjuha në gjuhë. *Hair* (flokë) është emër lënde në anglishte, ndërsa *cheveux* (fr.), *capelli* (it.) dhe *flokë* në shqipe janë emra të numërueshëm. Në anglishte dhe shqipe ka emra lënde në shumës, si *remains* apo *leftovers* (*mbeturina*), të lashtat⁴¹.

As përdorimi i përcaktorëve sasiore midis gjuhëve të këtij lloji nuk është i njëtrajtshëm, p.sh. *no* e anglishtes shkon edhe me lënde edhe me të numërueshëm (12a&b), ndërsa *nessuno* në italishte shkon vetëm me njëjtesin e emrave të numërueshëm (12c&d).

- 12 a. *no money: pa (asnjë) para* c. *nessuna auto: asnjë veturë*
 b. *no woman: asnjë grua* d. **nessuna acqua: asnjë ujë*

Siç do ta shohim më poshtë, një tjetër dallim është se në spanjishte tërë emrat mund të jenë edhe lënde edhe të numërueshëm. Në të vërtetë, edhe këta edhe ata mund të shfaqen njëlloj edhe në rend sintaksor lënde edhe në rend sintaksor të numërueshëm. Në spanjishte është lloji i referentit (send a substancë) që përcakton ç’rend sintaksor të përdoret (lënde a i numërueshëm). Ndryshe nga kjo, në gjuhë si anglishtja apo shqipja, lloji i referentit jepet nga klasa leksikore dhe vetitë morfosintaksore të emrit⁴².

Një dallim tjetër është se në gjuhë si anglishtja ekzistojnë emrat e

³⁹ E. Mathieu, “On the count / mass distinction in *Ojibwe*”, në *Count and mass across languages*, ed. by Diane Massam, Oxford: Oxford University Press. Botim i shtypur më shtator 2012, f. 172-198. (ISBN: 9780199654277)

⁴⁰ C. Gillon, “Mass, count and plurality in *Innu-aimun*”, punim i paraqitur në SULA V, Harvard / MIT, Maj 2009.

⁴¹ Shih: V. Chiarelli, R. El Yagoubi, S. Mondini, P. Bisiacchi, C. Semenza, “The Syntactic and Semantic Processing of Mass and Count Nouns: An ERP Study”, në *PloS one*, October, volume 6, issue 10, 2011. (doi:10.1371/journal.pone.0025885.)

⁴² Shih: E. Colunga, M. Gasser, “Attention to Different Cues in Noun Learning: The Effect of English vs. Spanish Mass / Count Syntax”, në *Proceedings of the 26th annual Boston University Conference on Language Development*, B. Skarabela, S. Fish and A. H.-J. Do Edits, Cascadilla Press, Somerville, MA. f. 107-117, 2002.

rremë të lëndës për të cilët do të flasim më poshtë.

Përmbledhtazi, pamë tri mënyra plotësisht të ndryshme me të cilat kodohet dallimi lënde – i numërueshëm. Me paraqitje skematike, në *gjuhët sasiore (klasifikuese)* zbulojmë një sjellje të veçantë: duhet gjithnjë një fjalë sasiore për të kombinuar një numëror themelor me një emër; në *gjuhët “me numër asnjans”* emri shfaqet në përndarjen e numërorëve, ndërsa në *gjuhët me numër të shënuar* dallimi prek përndarjen e morfemave njëjës – shumës. Brenda grupit të fundit gjejmë dallime të ndjeshme.

4. Kalimi nga lënde në të numërueshëm dhe ndërsjelltas

Në shumë raste, një emër mund të përdoret herë si lënde e herë si i numërueshëm, në mos me shpeshësi të njëjtë, të paktën me lehtësi të njëjtë. Kështu emrat *ropes (litar)*, *rock (gur)*, *tape (shirit)*, *beer (birrë)*, *tea (çaj)*, *coffee (kafe)* mund të tregojnë edhe substancë, si tek 13a&b, edhe sende më vete, si tek 13c&d:

- | | | | | |
|----|----|--|----|--|
| 13 | a. | <i>I need a lot of rope, rock, tape, ...</i> | c. | <i>I need three ropes, rocks, tapes...</i> |
| | b. | <i>(Më duhet shumë litar, gur, shirit...)</i>
<i>I drank a lot of beer, tea, coffee...</i>
<i>(Piva shumë birra, çaj, kafe...)</i> | d. | <i>(Më duhen tre litarë, gurë, shirita...)</i>
<i>I drank three, coffees, teas, beers...</i>
<i>(Piva tri birra, çaj, kafe...)</i> ⁴³ |

Ndodh edhe e kundërta: *chicken (pulë)* mund të tregojë edhe shpendin e të jetë i numërueshëm (14a) edhe substancën e të jetë lënde (14b):

- 14 a. *to cook a chicken (gatuaj një pulë)*
b. *to cook some chicken (gatuaj ca pulë (=mish pule))*

(A) *muffin (ëmbëlsirë e ngjashme me revaninë)* mund t'i referohet një ëmbëlsirë të vogël rrethore, pra një sendi, ndërsa *some muffin* mund t'i referohet një cope a racioni të kësaj ëmbëlsire, pra një substancë⁴⁴. Ka

⁴³ G. Chierchia, “Mass nouns, vagueness and semantic variation”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

⁴⁴ E. Colunga, M Gasser, “Attention to Different Cues in Noun Learning: The Effect of English vs. Spanish Mass / Count Syntax”, në *Proceedings of the 26th*

emra që në shumë gjuhë mund të përdoren edhe si lënde edhe si të numërueshëm. Ja disa shembuj marrë nga Barner dhe Snedeker⁴⁵: *chocolate/s* (çokollatë/a), *paper/s* (let(ë)r/a), *stone/s* (gur/ë), *string/s* (tel(ë)/a):

- 15 a. *Duhen dy metra telë bakri.*
b. *Kitara ka gjashtë tela.*

Spanjishtja, është një rast i skajshëm, pasi tërë emrat mund të jenë edhe lënde edhe të numërueshëm. *Madera* (*dru*) mund të jetë edhe emër lënde (*algo de madera* (*ca dru*)) edhe emër i numërueshëm (*una madera* (*një dru*)). Prandaj, emri *madera* nuk mund të quhet as i numërueshëm as lënde, meqë mund të shfaqet në të dyja rendet sintaksore. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për emrat e tjerë, si *hielo* (*akull*), *esponja* (*sfungjer*) etj., të cilët thuajse gjithnjë paraqiten në të dyja sintaksat⁴⁶.

Sipas disa filozofëve, se cilës klasë leksikore i përket emri përcaktohet nga konteksti a sintaksa. Prandaj Harry Bunt-i thotë: “Dallimi lënde – i numërueshëm nuk është vërtet dallim fjalësh, por dallim midis mënyrave sesi përdoren fjalët”^{47 48}. Edhe Gottlob Frege⁴⁹ ka një ide të ngjashme: “Nëse një emër i caktuar është i numërueshëm apo lënde varet nga aftësia për të vendosur ç’përdorim të veçantë apo ç’kuptim të veçantë t’i

annual Boston University Conference on Language Development, B. Skarabela, S. Fish and A. H.-J. Do Editons, Cascadilla Press, Somerville, MA, f. 107-117, 2002.

⁴⁵ D. Barner, J. Snedeker, “*Mapping individuation to mass-count syntax in language acquisition*”, Punim i paraqitur në *26th Annual Meeting of the Cognitive Science Society*, Zhvilluar 4-7 gusht, 2004, në Chicago, Illinois USA, Kenneth Forbus, Dedre Gentner and Terry Regier Editors, Copyright © 2005 by the Cognitive Science Society, f. 79 – 84. (ISBN 0-8058-5464-9; ISSN 1047-1316)

⁴⁶ Shih: V. C. M. Gathercole, “*The linguistic mass / count distinction as an indicator of the referent’s categorization in monolingual and bilingual children*”, në *Child Development* n.22, 395-415, 1997.

⁴⁷ H. C. Bunt, *Mass Expressions*, *Encyclopedia of Language & Linguistics*, Brown K. Edition, Amsterdam: Elsevier. f. 5757–5760, 2006.

⁴⁸ H. C. Bunt, “*The Formal Semantics of Mass Terms*”. Papers from the 2nd Scandinavian Conference on Linguistics, F. Kailsson Editor, Academy of Finland Turku, f.81 – 94, 1976.

⁴⁹ G. Frege, “*Über Sinn und Bedeutung*”, në *Funktion, Begriff, Bedeutung. Fünf logische Studien*, G. Pazing (Editor), Vandenhoeck und Ruprecht, Gottingen, f. 39 – 54, 1994.

caktojmë: lënde a i numërueshëm”. Për studiuesin Francis Jeffrey Pelletier⁵⁰ emri i lëndës *oatmeal* (bollgur tërshëre) shndërrohet në të numërueshëm në situatën kur një klient që darkon e pyet kamariere: “*How many oatmeals do you have?*” (“Sa bollgurë tërshëre keni në kuzhinë?”). Kjo ka një përgjigje të qartë “*Three oatmeals*” (“Tre bollgurë tërshëre”); dhe kamariere kryen ‘dy shkelje’ në lidhje me emrat e lëndës: përdorimin e shumësit dhe kombinimin me numërorin themelor *tre*; ndërkohë, klienti ka kryer dy: përdorimin e shumësit dhe përcaktorin sasiore (*many*) që shkon vetëm me emra të numërueshëm.

Në rastin e italishtes (dhe shqipës) kur porositet ‘*un caffè*’ (‘një kafe’), me kuptimin *una tazza di caffè* (një filxhan kafe), shprehja *una tazza di* (një filxhan (me)) është fshirë nga struktura sipërfaqësore⁵¹. Ndonjëherë kalimi ndodh për shkak të transferimit të kuptimit drejt kuptimit të ftytyruar si tek *smooth waters* (ujëra të prapatokës: liqene e lumenj).

Gennaro Chierchia kalimin nga lënde në të numërueshëm dhe ndërsjelltas e sheh si gjithësor (universal) dhe e quan *vetia e lakueshmërisë* (*elasticitetit*) (*elasticity property*). Ai zgjatet shumë të shpjegojë këtë dukuri. Niset nga emrat e lëndës që mund të përdoren si të numërueshëm. Ka dy mekanizma kryesorë që e kthejnë një emër lënde në të numërueshëm. Njëri ka kuptim sasish substance standarde ose natyrshëm të caktuara. *Shkëmbi* (*rock*), *litari* (*rope*) dhe *birra* (*beer*) konceptohen natyrshëm si substanca a material (që nevojisin emra lënde prototip). Megjithatë, duhet thënë se në natyrë substanca të tilla shfaqen ose në copa ose në sasi standarde. Për shembull, *rocks* (*gurë, shkëmbinj*) kur shfaqen si të numërueshëm u referohen copave të shkëmbit (pra sasive të plota, të kufizuara të shkëmbit); birrat (*beers*) janë sasi standarde birre (shishe, krikëlla); litarët duhet të jenë edhe kështu edhe ashtu (pra copa litari të plota ose sasi standarde, si p.sh., rrotulla). Në raste si këto, themi se emri

⁵⁰ F. J. Pelletier, *Mass Terms: Some Philosophical Problems*. Reidel, Dordrecht, 1979.

⁵¹ Shih: C. Semenza, S. Mondini, M. Cappelletti, “*The grammatical properties of mass nouns: An aphasia case study*”, në *Neuropsychologia*, Vol 35, No 5, © 1997 Elsevier Science Ltd, Printed in Great Britain, f. 669 – 675.

V. Chiarelli, R. El Yagoubi, S. Mondini, P. Bisiacchi, C. Semenza, “*The Syntactic and Semantic Processing of Mass and Count Nouns: An ERP Study*”, në *PloS one*, October, volume 6, issue 10, 2011. (doi:10.1371/journal.pone.0025885.)

ka dy natyra konceptimi: një të përparme lënde, dhe një të numërueshme të barabartë por të prejardhur⁵².

Ja ca shembuj të tjerë emrash lënde që lejojnë me pak a shumë lehtësi edhe përdorime si të numërueshëm. Kjo thënie tingëllon natyrshëm: *I drank three waters* (Piva tre ujë), ose shqip: *Sill dy çaj!* Në shqipe, përdorimi i emrave *ujë, çaj, verë, salcë* etj., si të numërueshëm në bar-bufe a restorant e përjashton shumësin (*ujëra, çajra, verëra*) mesa duket për të shmangur keqkuptimin me lloje çaji, vere, etj., pra një tjetër formë kalimi që do të shohim më poshtë. Nga ana tjetër, fjala *bukë* në shqipe e ka fituar të drejtën për të pasur shumës kur nënkupton sasi standarde më vete. Thënia “*Bleva tri bukë*” në shqipe përdoret më lehtë se “*I bought three breads*” në anglishte. Së fundi, ka ca emra që, për të kaluar nga lënde në të numërueshëm, kërkojnë një situatë ligjërimore shumë të spikatur. Thënia që vijon mund të ketë kuptim vetëm në një bar tejet ekzotik vampirësh: *I drank three bloods* (Piva tri gjaqe).

Këto dukuri janë kuptuar sipas nocionit *ambalazhues gjithësor* (*universal packager*), term i huazuar nga David Lewis⁵³, pra një funksion që emrat nga lënde i shndërron në të numërueshëm. Siç pamë në shembullin e fundit, zbatimi i tij nuk është aq i rrjedhshëm në çdo emër lënde.

Përveç asaj që thamë, në kalimin $L \rightarrow N$ (lënde $\rightarrow$ i numërueshëm) ka një mekanizëm tjetër që e kthen një emër që lidhet me një lloj substancash (*verë*) në një emër nënlojesh të këtyre substancave: *Më pëlqejnë vetëm tri verëra: merlot, kabërnet dhe shesh i zi*. Tri verëra interpretohet ‘tri lloje, soje, tipe verërash’. Ky kalim është i mundur thuajse me të gjithë emrat, me shkallë të ndryshme natyrshmërie⁵⁴. Ky mekanizëm nuk kufizohet tek

⁵² Shih: G. Chierchia, “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

⁵³ G. Chierchia (2010) dhe studiues të tjerë ia veshin studiuesit David Lewis këtë emërtim. Por Rey Jackendoff-i (2010), në një shënim f. 150 informon: “Vetë Lewis-i më ka thënë se nuk e ka përdorur në shkrim të botuar, por ia atribuon leksioneve ose shkrimeve të studiuesit Victor Yngve të viteve 60, të cilat nuk i gjen më”.

⁵⁴ Shih: M. L. P. Reyes, J. Macnamara, G. E. Reyes, H. Zolfaghari, “*Count nouns, mass nouns and their transformations: a unified category-theoretic semantics*”, në *Language, Logic and Concepts: Essays in Honour of John Macnamara*. R. Jackendoff, P. Bloom and K. Wynn, eds., MIT Press, Cambridge, MA, f. 427–452, 1999.

emrat e lëndës; ai e kthen një emër që lidhet me një lloj sendesh a individësh (qen) në një emër nënlojesh të këtyre sendeve a individëve: *Më pëlqejnë vetëm tre qenë: zagari, langoi dhe bulldogu*⁵⁵. Në rastin e emrave të numërueshëm, Veneeta Dayal⁵⁶ e vë theksin tek ajo se ata mund të kalojnë nga niveli i sendit në nivelin e llojit edhe me anë të përdorimeve përgjithësuese në njëjës të nyjës shquese *the*, si tek: *The dodo is extinct* (*Dodoja është zhdukur*).

T'i kthehemi tani kalimit $N \rightarrow L$ (i numërueshëm $\rightarrow$ lënde). Edhe këtu gjejmë raste ku një emër që konceptohet si i numërueshëm, ka pothuaj aq natyrshëm edhe një gjegjës lënde.

- 16 a. *I ate three apples, chickens,* b. *There is chicken in the*
rabbits,... *soup*
(Hëngra tri mollë, pula, lepuj, ...) *(Supa ka pulë)*⁵⁷.

Këtu siç duket jemi në gjendje të shndërrojmë të numërueshmin në lënde me anë të një veprimi që në dukje vë në punë nocionin 'pjesë nga substanca'. Shembulli përshkruan një situatë në të cilën ka mish pile në supë. Siç e tregojnë edhe përkthimet, ky kalim është njëlloj i natyrshëm edhe në shqipe. Emrat *pulë, mollë, lepur* etj. përdoren lehtë si lënde. Për t'u shënuar vlen edhe shembulli, në shqipe, i fjalës gazetë, normalisht i numërueshëm por natyrshëm edhe lënde: *E mbështolli bukën me gazetë. Fshiji xhamat me gazetë!*

Ky lloj kalimi mund të përgjithësohet edhe në shumë raste të tjera, por rezultatet janë më të spikatura. Ja disa shembuj nga anglishtja:

- 17 *LOVETT: Here we are, now! Hot out of the oven! (Më në fund! I sapodalë nga furra!)*
TODD: What is that? (Ç'është?)

⁵⁵ Shih: G. Chierchia, "Mass nouns, vagueness and semantic variation", në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

⁵⁶ V. Dayal, "Number Marking and (In)definiteness in Kind Terms", në *Linguistics and Philosophy*, Vol. 27, Issue 4, f. 393–450, 2004.

⁵⁷ Marie La Palme REYES, J. Macnamara, G. E. Reyes, H. Zolfaghari, "Count nouns, mass nouns and their transformations: a unified category-theoretic semantics", në *Language, Logic and Concepts: Essays in Honour of John Macnamara*. R. Jackendoff, P. Bloom and K. Wynn, eds., MIT Press, Cambridge, MA, f. 427–452, 1999.

LOVETT: *It's priest. Have a little priest. (Prift. Ha ca prift.)*

TODD: *Is it really good? (I mirë vërtet?)*

LOVETT: *Sir, it's too good at least! Then again, they don't commit sins of the flesh. So it's pretty fresh. (I shijshëm është pak të thuhet, zotrote. Për më tepër, ata nuk kryejnë mëkate mishi (trupi). Ndaj është mjaft i freskët).*

TODD: *Awful! A lot of fat! (Bah! I neveritshëm! Shumë yndyrë!)*

LOVETT: *Only where it sat! (Vetëm aty ku ulej (tek të pasmet!))*

TODD: *Haven't you got poet, or something like that? (Nuk ke poet, ose diçka të ngjashme?)*

LOVETT: *No, y'see, the trouble with poet is, 'Ow you don't know it's deceased? Try the priest! (Po dëgjo, puna e poetit është se... Nuk e dike që ka vdekur (mish i ngordhur)? Provo priftin!)*⁵⁸

Në këtë shembull marrë nga kinemaja, emrat prift dhe poet janë përdorur si lënde, një mënyrë thuajse e pazakontë, përveçse në një situatë ligjërimore si kjo bisedë midis dy antropofagësh.

Ja një shembull më i dëgjuar, nga Shekspiri:

18 *2nd Servant: Pray heauen it be not full of Knight againe. (Do zoti nuk ka prapë shumë kalorës)*

*1st Servant: I hope not, I had liefe as beare so much lead*⁵⁹.

Në anglishte, emri kalorës është përdorur pa shumës, pra si lënde, sipas studiuesve Beatrice Santorini dhe Anthony Kroch⁶⁰. Kjo ia vështirëson punën përkthyesit shqiptar, i cili doemos duhet të përdorë shumësin. Sidoqoftë, edhe shqipja njihet kështu përdorimesh, siç tregojnë shembulli nga e folmja e Tiranës (19a) dhe shembulli nga gegërishtja veriperëndimore (19b):

19 a. *Në pazar gëlonte katunari i modh! (kishte shumë fshatarë).*

b. *Sa malësori kishte ardh me pa shfaqjen! (Sa shumë malësorë kishin*

⁵⁸ Nga filmi *Sweeney Tod: The Demon Barber of Fleet Street*, Sondheim, 2007.

⁵⁹ W. Shakespeare, *Merry Wives of Windsor*, Act 4, Scene 2.

⁶⁰ B. Santorini, A. Kroch, *The syntax of natural language: An online introduction using the Trees program*. Kapitulli 5, "Extending the X schema", "supplementary material: Nouns", © 2007- Beatrice Santorini and Anthony Kroch. <http://www.ling.upenn.edu/~beatrice/syntax-textbook>. Parë më 20 maj 2016.

ardhur...)

Ne jemi të mendimit se këto përdorime, bashkë me atë të Shekspir, janë emra përmbledhës e jo lënde, njëlloj si *proletariati*. Por shembulli vijues, njëlloj si i pari, përfaqëson në mënyrë të pangatërrueshme kalimin nga emër i numërueshëm në lëndë.

- 20 *The article says that [Mr. Mangetout] once consumed fifteen pounds of bicycle in twelve days... Just as an example, I have never eaten so much as a pound of bicycle. ... I can see myself acting with considerable restraint at a dinner party at which the main course, is, say, queen-size waterbed*⁶¹.
(Artikulli thotë se zoti Manzhtu njëherë hëngri 15 livra biçikletë për dymbëdhjetë ditë... Meqë ra fjala, kurrë nuk kam ngrënë më shumë se një livër biçikletë. ... Mund ta shoh veten duke vepruar me shumë siklet në një gosti mbrëmjeje ku pjata kryesore është, le të themi, dyshek uji dopio e gjysmë).

Nocioni që përdoret në studime për mekanizmin që kthen një emër të numërueshëm në lëndë quhet *grirës gjithësor* (*universal grinder*), term i përdorur së pari nga Francis Pelletier-i sipas këshillës së David Lewis-it⁶². Këto dukuri nuk janë vetëm të anglishtes, shqipes apo gjuhëve të tjera indoevropiane. Të marrim gjuhën mandarine. Një emër si *ji* ‘pulë’ shkon njëlloj edhe me një fjalë sasiore si *zhi*, zakonisht e kufizuar tek sendet e plota (21a) dhe me një tjetër fjalë sasiore si *pan* (*enë*) që nuk është aq e kufizuar (21b); madje, në një stil të shkujdesur, *ji* (*pulë*) mund të shkojë edhe me sasioren e përgjithshëm *ge* (që zakonisht kombinohet vetëm me emra të numërueshëm) me të dyja interpretimet (21c)⁶³. Ndryshe nga kjo, përdorimi i sasiorit të përgjithshëm (të numërueshëm) *ge* me një emër lëndë që zor se përdoret si emër i numërueshëm (p.sh., *xue* ‘gjak’) duket

⁶¹ B. Santorini, A. Kroch, *The syntax of natural language: An online introduction using the Trees program*. Kapitulli 5, “*Extending the X schema*”, “supplementary material: *Nouns*”, © 2007- Beatrice Santorini and Anthony Kroch. <http://www.ling.upenn.edu/~beatrice/syntax-textbook>. Parë më 20 maj 2016.

⁶² F. J. Pelletier, “*Non-singular reference: some preliminaries*”, në *Philosophia* Vol. 5 No. 4, f. 451–465, Tetor 1975.

⁶³ Ting-Chi Wei, “*Nominal predicates in mandarin chinese*”, në *Taiwan Journal of Linguistics*, Vol. 5.2, f. 85 – 130, 2007.

më i shënuar, ose kërkon situata ligjërimore të veçanta (21d)⁶⁴. Kjo mesa duket vërteton se edhe në gjuhën mandarine *pulë* ka përdorime të natyrshme si i numërueshëm ose lënde, ndërsa *gjak* jo.

- 21 a. *san zhi ji* 'tri pula'
 b. *san pan ji* 'tri racione pulë'
 c. *san ge ji* 'tri pula' ose 'tri racione pulë'
 d. ??*san ge xue* 'tri racione gjak'

Përmbledhtazi, ka dy mënyra për të kaluar emrat e lëndës në të numërueshëm. Njëri ka kuptimin e sasive standarde apo natyrshëm të caktuara substance dhe quhet *ambalazhues gjithësor*. Tjetri e kthen një emër që lidhet me një lloj substancash në një emër nënlojesh të këtyre substancave. Këto kalime mesa duket janë të mundshme në të gjitha gjuhët; por mesa duket nuk janë plotësisht gjithësore (universale): varen fort nga situata ligjërimore dhe kanë përdorime të shkallëzuara. Modeli i shkallëzimit mesa duket është i qëndrueshëm ndër gjuhë; p.sh., *birra* është më e gatshme të shndërrohet në emër të numërueshëm sesa *gjaku*. Ka edhe një mekanizëm që e kthen emrin e numërueshëm në emër lënde dhe quhet *grirës gjithësor*. E thënë ndryshe, një emër që konceptohet si i numërueshëm, ka pothuaj aq natyrshëm edhe një gjegjës lënde.

5. Emra abstraktë lënde dhe të numërueshëm

Emrat e lëndës dhe ata të numërueshëm, jo vetëm emërtojnë realie të fushës konkrete, por edhe lloje të ndryshme konceptesh abstrakte: në anglishte, *knowledge* (dije), *advice* ('këshillë'), *beauty* (bukuri), *jealousy* (xhelozë), *anger* (zemërim), *courage* (guxim) quhen emra lënde. Nga ana tjetër, të numërueshëm janë *plot* (komplot), *quality* (cilësi), *virtue* (virtut), *belief* (besim), *idea* (ide): njeriu mund të ketë shumë ide⁶⁵. Ndonëse gjuhësia shqiptare nuk i përdor këto klasifikime, edhe në shqipe e gjejmë dallimin gramatikor lënde – i numërueshëm ndër emra abstraktë: *dashuri*, *frikë* sillen si emra lënde: *Më fal* (ca, shumë) *dashuri*. **Një dashuri*. *Mendim*, *ide* sillen si emra të numërueshëm: *Miri shprehu dy ide të reja*. Përgjithësisht, në gjuhët indoevropiane emrat abstraktë të lëndës përkrijnë

⁶⁴ L. L. Cheng, R. Sybesma, "Yi-wang Tang, yi-ge Tang: Classifiers and Massifiers", në *Tsing Hua Journal of Chinese Studies*, XXVIII(3), f. 385-412, 1998.

⁶⁵ C. Semenza, S. Mondini, M. Cappelletti, "The grammatical properties of mass nouns: An aphasia case study", në *Neuropsychologia*, Vol 35, No 5, © 1997 Elsevier Science Ltd, Printed in Great Britain, f. 669 – 675.

me emra abstraktë lënde e ndërjelltazi ata abstraktë të numërueshëm me emra abstraktë të numërueshëm: *love – dashuri, hatred – urrejtje* quhen emra lënde në anglishte dhe sillen si të tillë edhe në shqipe; po ashtu, *thought – mendim, quality – cilësi* quhen të numërueshëm në anglishte dhe sillen si të tillë edhe në shqipe. Megjithatë, kjo simetri nuk është e përsosur: *advice* është emër lënde në anglishte, *këshillë* sillet si emër i numërueshëm në shqipe.

Shumë filozofë do të ngurronin të përdornin dallimin lënde i numërueshëm kur bie fjala për koncepte abstraktë, meqë nuk kryhet lidhja emër lënde – substancë, emër i numërueshëm – send (individ).

Duhet thënë se, në anglishte, edhe emrat prejfoljorë që përfundojnë me -*ing* janë lënde, si *jumping* (hedhje) në kundërvënie me *to jump* (hidhem). Kjo nuk ndodh me emra të tjerë prejfoljorë të cilët kanë shumës e për këtë quhen të numërueshëm: *jump(s)* (hedhje), *knock(s)* (trokitje, goditje), *kick(s)* (shkelma), *shot(s)* (të shtëna) etj⁶⁶.

6. Emra të rremë lënde

Në gjuhë si anglishtja shfaqet dukuria e emrave që përkapen si të numërueshëm por nga ana morfosintaksore sillen si emra lënde, pra kanë përndarje të emrave të lëndës, si *furniture* (orendi, mobilim), *silverware* (argjende: enë, lugë, pirunj, thika të argjendta, të lara me argjend ose që duken prej argjendi), *cutlery* (takëm lugësh, pirunjsh thikash), *mail* (letërkëmbim), *footwear* (këpucë të ndryshme, në sasi të pacaktuar). Këta Valentina Chiarelli etj. i quan emra përmbledhës lënde “pasi tregojnë veti të ndërmjetme”⁶⁷. Edhe Carlo Semenza i bashkon me emrat përmbledhës dhe sqaron se ç’janë këto veti të ndërmjetme: “[Këta emra] kuptimisht shënojnë grupe elementesh që nuk mund të ndahen në çdo përbërës, por mund të kenë ose jo tiparin e numrit, ndërsa gramatikisht ndahen në të numërueshëm si *flock* (bagëti), dhe të panumërueshëm, si *furniture* (mobilim)”⁶⁸. Pra, sipas tyre, morfosintaksa dhe kuptimi mund të mos jenë në harmoni. Disa prej këtyre emrave u nënshtrohen rregullave gramatikore të emrave të numërueshëm, ndërsa disa të tjerë rregullave gramatikore të

⁶⁶ J. Doetjes, *Quantifiers and Selection* (Kapitulli 2: “*Mass and Count Properties of Nouns and Verbs*”). PhD dissertation, University of Leiden, Netherlands, 1997.

⁶⁷ V. Chiarelli, R. El Yagoubi, S. Mondini, P. Bisiacchi, C. Semenza, “*The Syntactic and Semantic Processing of Mass and Count Nouns: An ERP Study*”, në *PloS one*, October, volume 6, issue 10, 2011. (doi:10.1371/journal.pone.0025885.)

⁶⁸ C. Semenza, S. Mondini, M. Cappelletti, “*The grammatical properties of mass nouns: An aphasia case study*”, në *Neuropsychologia*, Vol 35, No 5, © 1997 Elsevier Science Ltd, Printed in Great Britain, f. 669 – 675.

emrave lëndës. Ndryshe nga këta, Chierchia nënvizon edhe një dallim kuptimor midis emrave të rremë të lëndës e emrave përmbledhës: “Vini re se emrat e rremë të lëndës nuk janë emra përmbledhës, si p.sh. emri *ekip*. Një njeri nuk është një ekip, ndërsa një llampë ose karrige mund të quhet *furniture (mobili)*: *That chair is cheap furniture (Ajo karrige është mobilje e lirë)*”⁶⁹. Gennaro Chierchia e disa studiues të tjerë këta i quan *emra të rremë lënde (fake mass nouns)*. Të tjerë studiues emrat e rremë të lëndës i quajnë *emra lënde të numërueshëm ose emra lënde individualë*. Ndërsa Barner dhe Snedeker i quajnë *emra lënde objektësh (object mass nouns)*⁷⁰.

Emrat e rremë të lëndës, kur paraprihen nga përcaktorë sasiore (*more...*), nënkuptojnë numër sendesh më vete (a individësh) ndërsa emrat prototip të lëndës, sasi substance. Këtë e ilustrojnë fjalitë e mëposhtme marrë nga punimi i studiuesve Alan Bale dhe David Barner⁷¹. Emrat e rremë të lëndës sillen kuptimisht (semantikisht) si të numërueshëm duke lejuar për një krahasim me numër sendesh më vete (individësh) (22a & b) ndërsa të tjerët nënkuptojnë krahasim lënde a vëllimi (22 c & d).

- 22 a. *Seymour has more equipment than Ed. (Sejmuri ka më shumë pajisje se Edi).*
 b. *Seymour has more furniture than Ed. (Sejmuri ka më shumë mobilje se Edi).*
 c. *Seymour has more water than Ed. (Sejmuri ka më shumë ujë se Edi).*
 d. *Seymour has more anger than Ed. (Sejmuri ka më shumë zemërim se Edi).*

⁶⁹ G. Chierchia, “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

⁷⁰ D. Barner, J. Snedeker, “*Mapping individuation to mass-count syntax in language acquisition*”, Punim i paraqitur në *26th Annual Meeting of the Cognitive Science Society*, Zhvilluar 4-7 gusht, 2004, në Chicago, Illinois USA, Kenneth Forbus, Dedre Gentner and Terry Regier Editors, Copyright © 2005 by the Cognitive Science Society, f. 79 – 84. (ISBN 0-8058-5464-9; ISSN 1047-1316)

⁷¹ A. Bale, D. Barner, “*Mass and Count at the Syntax / Semantics Interface*”, *Handout for workshop on Mass and Count Nouns*, University of Toronto, 7 – 8 shkurt, 2009.

Nga ana sintaksore, emrat e rremë të lëndës sillen si emra lënde prototip. Kështu, p.sh., nuk mund të kombinohen me numërorë themelorë (23a), përveçse kur ka edhe një sintagmë mase apo sasiore (23b); nuk kanë shumës e nuk pranojnë përcaktorë sasiore që shkojnë me emrat e numërueshëm (23c), por shkojnë vetëm me përcaktorë sasiore të emrave të lëndës (23d).

- 23 a. **I bought three furnitures.*
 (*Bleva tri mobilje.)
 b. *I bought three pieces of furniture.*
 (Bleva tri pjesë mobiljesh.)
 c. **I don't have many furnitures.*
 (*Nuk kam shumë mobilje.)
 d. *I don't have much furniture.*
 (Nuk kam shumë mobilje.)

Megjithatë, Roger Schwarzschild⁷² ka zbuluar një klasë mbiemrash që nuk kombinohen me emrat e lëndës prototip. Këta mbiemra i quan *Stubbornly Distributive Predicates (STUBs)* (Mbiemra përndarës kokë mushkë (MPK)): *large* (i madh), *small* (i vogël), *cubical* (kubik), *big* (i madh), *round* (rrethor) etj. Kur shfaqen si kallëzues emërorë të emrave të numërueshëm në shumës, mbiemrat MPK (STUBs) ua përndajnë kuptimin secilit element (24a). Le ta krahasojmë këtë me shembullin 24b. Ky shembull i dytë, në njërin nga kuptimet është njëlloj me të parin, pra ka kuptim përndarës: secila vjollcë zë pak vend. Në kuptimin tjetër është përmbledhës: tërë vjollcat zënë pak vend. E njëjta ndodh me emrat e rremë të lëndës (24c): kallëzuesi emëror këtu interpretohet si përndarës. Ndërsa me emra lënde prototip si *snow* (borë), mbiemrat MPK (STUBs) nuk shkojnë (24d). Pra, përse i përket kësaj klase mbiemrash, emrat e rremë të lëndës sillen njëlloj si emrat e numërueshëm shumës dhe jo si emrat e lëndës prototip. Prandaj, vërtet emrat e rremë të lëndës në shumë drejtime sillen si emra lënde prototip, mirëpo ka qoshe të gramatikës ku ata u ngjajnë më shumë emrave të numërueshëm.

- 24 a. *Those violets are small.* përndarës

⁷² R. Schwarzschild, "Mass Nouns and Stubbornly Distributive Predicates", punim i paraqitur në *Harvard Colloquium Series, STUBs / Pluralities*, shtator 2007.

- (Ato vjollca janë të vogla).
- b. *Those violets occupy little space.* përndarës, përmbledhës
(Ato vjollca zënë pak vend).
- c. *That furniture is small.* përndarës
(Ai mobilim është i vogël)
- d. **That snow is small.* ???
(*Ajo borë është e vogël).

Një karakteristikë tjetër e emrave të rremë të lëndës është se ata sillen ndryshe edhe brenda gjuhëve të afërta që e shënojnë shumësin. P.sh. frëngjishtja dhe italishtja kanë emra plotësisht gjegjës por të numërueshëm për *furniture* të anglishtes. Në të vërtetë ato kanë çifte minimale, siç tregon ky shembull i marrë nga Gennaro Chierchia⁷³:

25	italisht:	mobile (nj., i num.)	mobili (sh., i num.)	mobilia (lënde)
	anglisht:	piece of furniture	pieces of furniture	furniture

Gjegjësi në italishte i emrit anglisht *footwear*: *calzatura/e* është gjithashtu i numërueshëm etj. Nëse Tsoulas 2006⁷⁴ ka të drejtë, greqishtja nuk duhet të ketë asnjë emër të rremë lënde.

Ajo që i bën tërheqës emrat e rremë të lëndës është se edhe përbëjnë një tip pak a shumë të dendur të emrave të lëndës jo themelorë (jo prototip) edhe shfaqin ndryshime midis gjuhëve shumë të afërta. Mesa dimë, dukuria e *emrave të rremë të lëndës* duhet të kufizohet vetëm tek gjuhët me shumës të shënuar. Nuk dihet mirë nëse *gjuhët sasiore (klasifikuese)* si gjuha mandarine dhe shumë *gjuhë me numër asnjans* si *dëne sùline* kanë një klasë emrash që përkapen si të numërueshëm por që kanë përdorime morfosintaksore si të emrave të lëndës. E thënë ndryshe, në gjuhën mandarine, çdo lloj emri i numërueshëm sillet si emër i rremë lënde. Për shkak të kësaj sjelljeje të ndërlikuar, emrat e rremë të lëndës përbëjnë një bazë të fortë për teoritë e dallimit lënde – i numërueshëm.

7. Përfundime

⁷³ G. Chierchia, “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese* n°174, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)

⁷⁴ G. Tsoulas, “*Plurality of Mass Nouns and the Grammar of Number*”, punim i paraqitur në *29th Glow Meeting*, Barcelona, 2006.

Dallimit ontologjik send substancë i përkon dallimi gjuhësor emër i numërueshëm – lënde. Dallimi emër lënde – i numërueshëm është së pari gramatikor. Emrat e numërueshëm kanë shumës, kanë nyje shquese dhe joshquese, mund të ndjekin numërorë themelorë, nuk marrin disa përcaktorë sasiore si *much* dhe *little* por marrin disa fjalë sasiore që nënkuptojnë numër sendesh më vete si *several*, *these (këta)*, *those (ata)*, *few (ca)*, *many (shumë)*. Ka sasiore të tjerë si *every (çdo)* që shkojnë vetëm me njëjës in e emrave të numërueshëm. Nga ana tjetër, emrat e lëndës, nuk kanë dallimin njëjës - shumës dhe janë thujse gjithnjë në njëjës. Nuk mund të marrin nyje joshquese, nuk mund të marrin numërorë themelorë (vetia e firmës) e të tjerë përcaktorë sasiore që nënkuptojnë numër sendesh më vete (individësh) si *another (tjetër)*, *many (shumë)*. Sidoqoftë, mund të marrin përcaktorë sasiore, si *some (ca)*, *little (pak)*, *much (shumë)*. Ka një klasë përcaktorësh sasiore që shkojnë edhe me shumësin e emrave të numërueshëm edhe me emrat e lëndës, por përjashtojnë njëjës in e emrave e numërueshëm, si *most*, *all*.

Sipas mënyrave me të cilat kodohet dallimi lënde – i numërueshëm, gjuhët ndahen në tri grupe: *gjuhë sasiore (klasifikuese)*, *gjuhë me numër të shënuar dhe gjuhë me numër asnjës*. Në *gjuhët sasiore (klasifikuese)* duhet gjithnjë një fjalë sasiore për të kombinuar një numëror themelor me një emër; në gjuhët me numër të shënuar dallimi prek përndarjen e morfemave njëjës – shumës, ndërsa në *gjuhët me numër asnjës* emri shfaqet në përndarjen e numërorëve.

Ka dy mënyra për të kaluar emrat e lëndës në të numërueshëm. Njëri ka kuptimin e e sasive standarde apo natyrshëm të caktuara substance dhe quhet *ambalazhues gjithësor*. Tjetri e kthen një emër që lidhet me një lloj substancash në një emër nënlojesh të këtyre substancave. Ka edhe një mekanizëm që e kthen emrin e numërueshëm në emër lënde dhe quhet *grirës gjithësor*. Një emër që konceptohet si i numërueshëm, ka pothuaj aq natyrshëm edhe një gjegjës lënde.

Gjuhësia angleze i klasifikon si lënde ose të numërueshëm edhe emrat abstraktë, pasi, nga ana morfosintaksore, ata sillen ose kështu ose ashtu. Në anglishte edhe emrat prejfoljorë që përfundojnë me *-ing* janë lënde. Gjuhë si anglishtja kanë emra të rremë lënde. Këta, semantikisht, konceptohen si të numërueshëm por nga ana morfosintaksore sillen si emra lënde, pra kanë përndarje të emrave të lëndës. Sidoqoftë, ka disa qoshe të sintaksës ku emrat e rremë të lëndës sillen më shumë si emra të numërueshëm sesa si lënde.

BIBLIOGRAFI

- Audrey LI, Y.-H., “*Plurality in a Classifier Language*”, në *Journal of East Asian Language*, Vol. 8, f. 75-99, 1999.
- Bale, A., Barner, D., “*Mass and Count at the Syntax / Semantics Interface*”, *Handout for workshop on Mass and Count Nouns*, University of Toronto, 7 – 8 shkurt, 2009.
- Barner, D., Snedeker, J., “*Mapping individuation to mass-count syntax in language acquisition*”, Punim i paraqitur në *26th Annual Meeting of the Cognitive Science Society*, Zhvilluar 4-7 gusht, 2004, në Chicago, Illinois USA, Kenneth Forbus, Dedre Gentner and Terry Regier Editors, Copyright © 2005 by the Cognitive Science Society, f. 79 – 84. (ISBN 0-8058-5464-9; ISSN 1047-1316)
- Bunt, H. C., “*The Formal Semantics of Mass Terms*”. Papers from the 2nd Scandinavian Conference on Linguistics, F. Kailsson Editor, Academy of Finland Turku, f.81 – 94, 1976.
- Bunt, H. C., *Mass Expressions, Encyclopedia of Language & Linguistics*, Brown K. Edition, Amsterdam: Elsevier. f. 5757–5760, 2006.
- Burge, T., “*Mass terms, count nouns and change*”, në *Synthese* 31, f. 459 - 468, 1975.
- Cheng, L. L., Sybesma, R., “*Yi-wang Tang, yi-ge Tang: Classifiers and Massifiers*”, në *Tsing Hua Journal of Chinese Studies*, XXVIII(3), f. 385-412, 1998.
- Chiarelli, V., El Yagoubi, R., Mondini, S., Bisiacchi, P., Semenza, C., “*The Syntactic and Semantic Processing of Mass and Count Nouns: An ERP Study*”, në *PloS one*, October, volume 6, issue 10, 2011. (doi:10.1371/journal.pone.0025885.)
- Chierchia, G., “*Mass nouns, vagueness and semantic variation*”, në *Synthese n°174*, Harvard University Press, f. 99–149, 2010. (doi:10.1007/s11229-009-9686-6)
- Chierchia, G., “*Reference to Kinds across Languages*”, në *Natural Language Semantics*, 6: 339-405, 1998.
- Chierchia, G., *Plurality of Mass Nouns and the Notion of ‘Semantic Parameter’*, në S. Rothstein (ed.) *Events and Grammar*, Kluwer, Dordrecht, 1998.
- Colunga, E., Gasser, M., “*Attention to Different Cues in Noun Learning: The Effect of English vs. Spanish Mass / Count Syntax*”, në *Proceedings of the 26th annual Boston University Conference on Language Development*, B. Skarabela, S. Fish and A. H.-J. Do

- Editons, Cascadilla Press, Somerville, MA. f. 107-117, 2002.
- Dayal, V., “*Number Marking and (In)definiteness in Kind Terms*”, në *Linguistics and Philosophy*, Vol. 27, Issue 4, f. 393-450, 2004.
- Doetjes, J., *Quantifiers and Selection* (Kapitulli 2: “*Mass and Count Properties of Nouns and Verbs*”). PhD dissertation, University of Leiden, Netherlands, 1997.
- Frege, G., “*Über Sinn und Bedeutung*”, në *Funktion, Begriff, Bedeutung. Fünf logische Studien*, G. Pazing (Editor), Vandenhoeck und Ruprecht, Göttingen, f. 39 – 54, 1994.
- Gathercole, V. C. M., “*The linguistic mass / count distinction as an indicator of the referent’s categorization in monolingual and bilingual children*”, në *Child Development* n.22, 395-415, 1997.
- Gillon, B. S., “*Towards a common semantics for English count and mass nouns*”, në *Linguistic and Philosophy* 15, f. 597 – 639, 1992.
- Gillon, C., “*Mass, count and plurality in Innu-aimun*”, punim i paraqitur në SULA V, Harvard / MIT, Maj 2009.
- Jackendoff, R., “*Meaning and the Lexicon: The Parallel Architecture 1975-2010*”, © Ray Jackendoff 2010, Oxford University Press 2010. (ISBN 978-0-19-956888-8 (Pbk.))
- Kurafuji, T., “*Plural Morphemes, Definiteness and the Notion of Semantic Parameter*”, në *Language and Linguistics*, n. 5.1, f. 211-242, 2004. (ISBN: 2004-0-005-001-000077-1)
- Levelt, W. J. M., *Speaking: From Intention to Articulation*. MIT Press, Cambridge, MA, 1989.
- Macnamara, J., Reyes, G. E., *The Logical Foundation of Cognition*. Oxford University Press, Oxford, 1994.
- Mathieu, E., “*On the count / mass distinction in Ojibwe*”, në *Count and mass across languages*, ed. by Diane Massam, Oxford: Oxford University Press. Botim i shtypur më shtator 2012, f. 172-198. (ISBN: 9780199654277)
- Nelson, D., Toivonen, I., “*Counting and the grammar: case and numerals in Inari Sami*”, në Nelson, D. Manninen, S. eds. *Generative Approaches to Finnic and Saami Linguistics*, CSLI Publishers, f. 313-334, 2003.
- Pelletier, F. J., “*Non-singular reference: some preliminaries*”, në *Philosophia* Vol. 5 No. 4, f. 451–465, Tetor 1975.
- Pelletier, F. J., *Mass Terms: Some Philosophical Problems*. Reidel, Dordrecht, 1979.
- Reyes, M. La Palme, Macnamara, J., Reyes, G. E., Zolfaghari, H., “*Count*

- nouns, mass nouns and their transformations: a unified category-theoretic semantics”, në *Language, Logic and Concepts: Essays in Honour of John Macnamara*. R. Jackendoff, P. Bloom and K. Wynn, eds., MIT Press, Cambridge, MA, f. 427–452, 1999.
- Santorini, B., Kroch, A., *The syntax of natural language: An online introduction using the Trees program*. Kapitulli 5, “Extending the *X* schema”, “supplementary material: Nouns”, © 2007, Beatrice Santorini and Anthony Kroch.
<http://www.ling.upenn.edu/~beatrice/syntax-textbook>.
- Schwarzschild, R., “*Mass Nouns and Stubbornly Distributive Predicates*”, punim i paraqitur në shtator 2007, në *Harvard Colloquium Series, STUBs / Pluralities*, 2007.
- Semenza, C., Mondini, S., Cappelletti, M., “*The grammatical properties of mass nouns: An aphasia case study*”, në *Neuropsychologia*, Vol 35, No 5, © 1997 Elsevier Science Ltd, Printed in Great Britain, f. 669 – 675, 1997.
- Shakespeare, W., *Merry Wives of Windsor*, Act 4, Scene 2.
- Todd, S., *The Demon Barber of Fleet Street*, Sondheim, 2007 (film).
- Tsoulas, G., “*Plurality of Mass Nouns and the Grammar of Number*”, punim i paraqitur në 29th Glow Meeting, Barcelona, 2006.
- Wei, T.-Ch., “*Nominal predicates in mandarin chinese*”, në *Taiwan Journal of Linguistics*, Vol. 5.2, f. 85 – 130, 2007.
- Wilhelm, A., “*Bare Nouns in Dëne Sùline*”, në *Natural Language Semantics*, 16, f. 39-68, 2008.